



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TRAJNIMIT
TË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PJESA E DYTË,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e Manualit të trajnimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, pjesa e dytë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", i ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimi i KQZ nr.17, datë 01.02.2019, "Për miratimin e strategjisë së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës të përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, kryen kurse trajnimi për anëtarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019. Në zbatim të strategjisë së trajnimit është përgatitur Manuali i trajnimit dhe Fletore e punës së KZAZ-së, pjesa e dytë.

Manuali i trajnimit të KZAZ-së, pjesa e dytë, është konceptuar për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të KZAZ-ve në veprimtarinë e tyre për administrimin e procesit në zonën e administrimit zgjedhor nga përgatitja e Vendit të Numërimit tëVotave deri në dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQZ.



Nr. 801i Vendimit Data 6.6.2019 e Vendimit Ora 19³⁰ e Vendimit

Për miratimin e Manualit të trajnimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, pjesa e dytë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Manuali përmban detyrat e KZAZ-së në VNV, vendimet dhe dokumentacionin e punës së KZAZ-së, për çdo procedurë si dhe përgjegjësitë dhe sanksionet për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së.

Manuali i trajnimit të KZAZ-së, pjesa e dytë,

- është material kryesor i KZAZ-së që do të përdoret nga anëtarët e saj gjatë kurseve të trajnimit që do organizojë KQZ;
- qartëson detyrat e KZAZ, duke ndërthurur përcaktimet e Kodit Zgjedhor me detajimet e akteve nënligjore të KQZ-së;

dhe

- do të shërbejë si një instrument pune për ta[anëtarët] në përmbushjen korrekte të detyrave për administrimin e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

Njohja, kuptimi dhe përvetësimi i procedurave të parashikuara në këtë manual, do të ndikojë në:

- ngritjen e nivelit profesional e administrues të anëtarëve të KZAZ-ve;
- zgjidhjen me profesionalizëm, paanshmëri, efektivitet nga ana e komisionerëve të KZAZ-ve të të gjitha problematikave të krijuara gjatë ushtrimit të detyrës;

Komisionerët gjatë trajnimit dhe ushtrimit të detyrës do të përdorin modelet e vendimeve dhe dokumentet e punës së tyre, të cilat janë në përmbajtjen e Fletores së Punës, pjesa e dytë, me qëllim që të përvetësojnë sa më mirë të gjitha procedurat e parashikuara në Manualin e KZAZ-së pjesa e dytë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Manualin e trajnimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, pjesa e dytë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Fletoren e Punës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, pjesa e dytë, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare



Nr. 801i Vendimit Data 6.6.2019 e Vendimit Ora 19³⁰ e Vendimit

Për miratimin e Manualit të trajnimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, pjesa e dytë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019